



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 163

Tiranë – E premte, 10 nëntor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 314, datë 6.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19583
Dekret i Presidentit nr. 315, datë 6.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19583
Dekret i Presidentit nr. 316, datë 6.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19583
Dekret i Presidentit nr. 317, datë 6.11.2023	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19584
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 8.11.2023	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Durrës, të pasurive 36, 37, 338/2 dhe 338/1, me vendndodhje në zonën kadastrale 8517, dhe për një shtesë në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar..... 19584
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 8.11.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 494, datë 30.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Jashtme”..... 19587
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 628, datë 8.11.2023	Për hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit të mesëm të ulët “Ecole Internationale”, ku mësimi zhvillohet në gjuhën frënge..... 19590
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 629, datë 8.11.2023	Për përcaktimin e procedurës dhe mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor..... 19590
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 13, datë 2.11.2023	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 3.2.2022, “Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për drejtuesit e mjeteve që kryejnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifatat përkatëse”..... 19591

Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 14, datë 2.11.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 3.2.2022, “Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për këshilltarët e sigurisë në transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifatat përkatëse”.....	19593
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 125, datë 12.10.2023	Për delegim kompetence.....	19593
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 241, datë 23.10.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”, i ndryshuar.....	19594
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 640, datë 6.11.2023	Për delegim kompetencash.....	19596
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 281, datë 25.9.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s, për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë sigurorese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	19596
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 282, datë 25.9.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Idi 2005” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”.....	19597
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 283, datë 25.9.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 25.1.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Pishat’, me kapacitet të instaluar 1911 kw”.....	19599
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 284, datë 25.9.2023	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Vardari’ me kapacitet të instaluar 1972 kw”, i ndryshuar.....	19600



DEKRET
Nr. 314, datë 6.11.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Andrea Gentjan Alliaj
2. Brunilda Tonin Qotja (Vasa)
3. Skënder Stavri Xharo
4. Isra Petrit Podgorica

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 315, datë 6.11.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Xhimi Bardhok Bibaj
2. Donis Ilir Paci

3. Nilka Hekuran Krasniqi (Gjurra)
4. Margarita Qemal Sadiku (Albrahimi)
5. Miranda Xhavit Hoxha
6. Arian Sulejman Aliaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 316, datë 6.11.2023

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Iu lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Ledio Vadim Avxhi
2. Flogert Fadil Muhaj
3. Blerta Jakup Alliaj (Zotaj)
4. Xhoana Artan Durro
5. Xhesika Besnik Osmani

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 317, datë 6.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 13, nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Iu lejohej lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Sindrit Vladimir Zeqiri
2. Geralda Avdulla Aliaj
3. Irena Hysen Reichert (Kuqi)
4. Theodhora Fatmir Kasa
5. Kejda Betim Lushkja
6. Stela Vadim Schmude (Lila)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

VENDIM**Nr. 625, datë 8.11.2023**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË DURRËS, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE DURRËS, TË
PASURIVE 36, 37, 338/2 DHE 338/1, ME
VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE 8517, DHE PËR NJË
SHITESË NË VENDIMIN NR. 536, DATË
1.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “d”, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të

paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Durrës, për Njësinë Administrative Durrës, të pasurive 36, 37, 338/2 dhe 338/1, me vendndodhje në zonën kadastrale 8517, sipas formularëve dhe planit të rlevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t’u përdorur për kryerjen e veprimtarive social-kulturore e sportive.

2. Pasuritë e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohen listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Durrës i ndalohet ndryshimi i destinacionit dhe tjetërsimi i pasurive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Bashkia Durrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia / Komuna : Durrës

Identifikoi: Fatjon Zeqiri (Specialist) Ervis Bahiti (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Pranvera Gagani (Pergj. Sek. Pronave)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Elio Jani Emiriana Sako
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulgë) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vulgë)

Fusha e perdorimit te Prones: Pona qe perdoren ne fushen e infrastruktures dhe sherbimeve publike , si dhe per realizimin e funksioneve apo sherbimeve te tjera ne funksion te Bashkise

Nr. Rend.	A			B		C			Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)	
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative		Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit
1	8517 K-34-87-(239-A)	36	Truall	ECO Park Bashkia Durrës	145994 m2	7	8	9	10	11
					73282 m2					Kjo pasuri perfishin pasuritë (36, 338/2, 338/1, 37)
		338/2			1814 m2					Pasuria 36 me sip 73282 m2
		338/1			1959 m2					Pasuria 338/2 me sip 1814 m2
		37			68939 m2					Pasuria 338/1 me sip 1959m2
										Pasuria 37 me sip 68939 m2



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE						
PRONARI _SHTET_		DATE 23/06/2023		QELIMI _PER REGJISTRIM		
VENDNDODHJA BASHKIA DURRES		DVASHK/ZVASHK DURRES		ZONA KADASTRALE 8517		NUMRI PASURISE 36,37,338/2,338/1
TE DHENAT E PASURISE LLOJI PASURISE TRUALL		SIP.PASURISE=145994 m2		SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= - m2		NUMRI KATEVE -
						INDEX HARTE K-34-87-(239-A)
						NUMRI PEMEVE

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 452552
Y 4582553

X 454559
Y 4582553

SH 1:2500

X 452552
Y 4581311

X 454559
Y 4581311

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	V			344/3		
2	J			332/1		
3	L			339/2		
4	P			337/1		

REALIZOI PER BASHKINE DURRES PUNOI: FATJON ZEQRIRI ERSIS BAHITI PERGJEGJES SEKTORI PRONAVE: PRANVERA GAGANI NENSHKRIMI DREJTORIA LIGJORE : ELIJANI NENSHKRIMI KRYETAR: EMIRJANA SAKO NENSHKRIMI	TEKNOLOGJIA E MATJEVE: Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; PERCAKTIMI KUFIRIT: _KP;HK. Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale; SHENIME TE VECANTA: PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET EMRI _____ NENSHKRIMI _____
--	---

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

**VENDIM****Nr. 626, datë 8.11.2023**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 494, DATË 30.6.2005, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHETËTORRE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
PUNËVE TË JASHTME”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 494, datë 30.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së

inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Jashtme”, lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e përmendur në pikën 1, e cila përbëhet nga 2 (dy) fletë, zëvendësohet me formularin dhe planrilevimin që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET **DATE 28/09/2023** **QELLIMI: Perditesim**

VENDNDODHJA
 BASHKIA - TIRANE DVASHK/ZVASHK - TIRANE VERI ZONA KADASTRALE: 8150 NR. I PASURISE: 4/282 INDEX HARTE: TR; N-14, O-14
 TE DHENA TE PASURISE
 LLOJI PASURISE: TRUALL+ND SIP. PASURISE=10665.6 m² SIPERFAQJA GJURMES NDERTIMIT= 2586 m² NUMRI KATEVE: 1-4KAT + BODRUM NUMRI PEMEVE: _____

X=485858.34 Y=4577319.75 **KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE** X=486043.42 Y=4577319.75

SHKALLA 1:500

NR.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARET	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			PASURIA 4/281 (SHTET)		
2	LINDJE			PASURIA 4/282 (SHTET)		
3	JUG			PASURIA 4/283, 4/300 (SHTET)		
4	PERENDIM			PASURIA 5/252, 5/686, 5/287, 5/343, 5/299		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT:
 EMRI: _____
 LICENCA NR. _____ DATE _____
 KOMPANIA: _____ NIPT: _____
 NENSHKRIMI/VULA _____
 REALIZOI PER ASHK: _____ DV/ASHK TIRANA VERI
 SPECIALISTI: ANIDA SHEHU _____ Arkada _____
 NENSHKRIMI _____ Shkruar _____
 KONFIRMOI: _____
 PERGJEGJES SEKTORI: BLENDAR BODLI _____ Shkruar _____
 NENSHKRIMI/VULA _____ Shkruar _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; D-Matje Distancash;
PERCARTIMI KUFIRIT: P-Perfaqesues i Pronareve; KP-Kufitare Pjeserisht; HK-Harta Kadastrale
SHENIME TE VECANTA:
 PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET
 EMRI: MINISTRIA PER EUROPEEN DHE PUNET E JASHTME
 KONFIRMOI: _____
 SEKRETAR I PERGJITHSHEM: GAZMEND TURDU _____
 NENSHKRIMI/VULA _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitare te Gjithe; KP-Kufitare Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

[illegible]

**VENDIM****Nr. 628, datë 8.11.2023**

**PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT
ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR
TË ARSIMIT TË MESËM TË ULËT
“ECOLE INTERNATIONALE”, KU
MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN
FRËNGE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e institucionit arsimor privat parauniversitar të arsimit të mesëm të ulët “*Ecole Internationale*”, me kohë të plotë, i cili ushtron veprimtarinë arsimore, në adresën: rruga Tiranë–Elbasan, km 5, Lundër, Tiranë, me numër pasurie 867/19. Në këtë institucion arsimor mësimi zhvillohet në gjuhën frënge, ndërsa lëndët “Gjuhë shqipe”, “Histori e kombit shqiptar” dhe “Gjeografi e Shqipërisë” zhvillohen detyrimisht në gjuhën shqipe.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, dhe institucioni arsimor privat parauniversitar i arsimit të mesëm të ulët “*Ecole Internationale*” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 629, datë 8.11.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS
DHE MËNYRËS SË KOMPENSIMIT TË
DREJTË PËR PËRDORIMIN E
VEPRAVE PA AUTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 75/2, të ligjit nr. 35/2016, “Për të

drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e procedurës e të mënyrës së kompensimit të drejtë për përdorimin e veprave pa autor.

2. Për qëllim të këtij projektvendimi, termat “vepër pa autor” dhe “kompensim i drejtë” kanë të njëjtn kuptim si në ligjin nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar.

3. Autori, bashkautori ose agjencia e administrimit kolektiv, e autorizuar nga autori ose bashkautori, paraqesin një kërkesë me shkrim për dhënien fund të statusit për veprat pa autor dhe për përlogaritjen e kompensimit të drejtë.

4. Kërkesa për kompensimin e drejtë paraqitet tek institucioni i cili ka përdorur veprën pa autor.

5. Kërkesa për kompensimin e drejtë shoqërohet me dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Dokumentin e identifikimit të autorit ose bashkautorit;

b) Dokumentin që vërteton se kërkuksi është titullar i të drejtave për veprën pa autor;

c) Të dhënat për vendndodhjen e autorit ose të bashkautorit;

ç) Aktin noterial të përfaqësimit në rast se kërkesa kryhet nga një përfaqësues ligjor;

d) Vendim gjykate për të vërtetuar se kërkuksi është titullar i të drejtave për veprën pa autor, në pamundësi për të plotësuar kushtin e shkronjës “b” të kësaj pike.

6. Institucionet e parashikuara në pikën 1, të nenit 16/2, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar, përcaktojnë shumën e kompensimit të drejtë dhe mënyrën e shpërblimit, në konsultim me autorin ose bashkautorin, pasi kanë përfunduar statusin “vepër pa autor”.

7. Shuma e kompensimit të drejtë përcaktohet sipas kategorive të veprave pa autor, duke marrë parasysh:

a) qëllimin e përdorimit të veprës, sipas përcaktimit të nenit 75/2, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar;



b) dëmin e shkaktuar autorit ose bashkautorit gjatë përdorimit të veprave pa autor, në lidhje me të drejtat personale pasurore dhe jopasurore të tyre;

c) shpenzimet e institucionit për të kryer kërkimet shteruese për përcaktimin e statusit “vepër pa autor”, digjitalizimin, indeksimin, katalogimin, ruajtjen apo edhe vënien në dispozicion të publikut të veprës pa autor.

8. Nëse shuma e kompensimit të drejtë dhe mënyra e shpërblimit nuk përcaktohen pas konsultimit me autorin ose bashkautorin, ajo përcaktohet bazuar në metodologjinë dhe masat e tarifave të shpërblimit të veprave të mbrojtura nga e drejta e autorit në sistemin e administrimit kolektiv, duke iu referuar së njëjtës kategori veprash.

9. Pas përfundimit të statusit “vepër pa autor” dhe kompensimit të drejtë, institucioni përdor veprën vetëm me autorizim/kontratë me shkrim të autorit, bashkautorit apo titullarit të të drejtave të veprës origjinale.

10. Institucioni njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse për të drejtën e autorit për përfundimin e statusit “vepër pa autor” dhe fillimin ose jo të procedurave për kompensimin e drejtë.

11. Ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit përditëson bazën e të dhënave për veprat pa autor.

12. Kompensimi paguhet nga institucioni që ka përdorur veprën.

13. Nëse vepra është në bashkautorësi, kompensimi i paguhet titullarëve të të drejtave bashkërisht. Në rast të mungesës së informacionit për pjesën takuese të secilit bashkautor, kompensimi paguhet në masa të barabarta.

14. Në rast se autori ose bashkautorit nuk janë dakord me shumën e kompensimit, ato kanë të drejtën e ankimit sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

15. Autori ose bashkautorit kanë të drejtën e ankimit në gjykatë.

16. Ngarkohen Ministria e Kulturës, bibliotekat publike, institucionet arsimore, muzetë, personat e tjerë juridikë që kryejnë veprimtari muzeore, arkivat dhe transmetuesit publike që janë krijuar në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM

Nr. 13, datë 2.11.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 3.2.2022, “PËR PROGRAMIN, TRAJNIMIN, TESTIMIN DHE LËSHIMIN E CERTIFIKATËS PËR DREJTUESIT E MJETEVE QË KRYEJNË TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME DHE TARIFAT PËRKATËSE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 38, 63, të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, dhe të neneve 115/1, 119, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 3.2.2022, “Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për drejtuesit e mjeteve, që kryejnë transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifët përkatëse”, bëhen këto ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

I. Në nenin 16, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2, shkronja “d”, nënparagrafi “i”, ndryshon si më poshtë:

“i. me cisternë: 7 orë x 400 lekë/ora = 2 800 lekë”;

b) Pika 4, ndryshon si më poshtë:

“4. Tarifa për zëvendësimin e certifikatës së trajnimit (dublikatë), në rast humbjeje, dëmtimi apo ndryshim vendbanimi është 2 000 lekë”;

c) Pika 5, ndryshon si më poshtë:

“5. Tarifa për pajisjen me certifikatën e trajnimit për herë të parë është 3 500 lekë”.

Neni 2

Aneksi “Modeli i certifikatës së trajnimit të drejtuesit të mjetit ADR”, zëvendësohet nga aneksi me të njëjtin titull, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku



ANEKSI

MODELI I CERTIFIKATËS SË TRAJNIMIT E DREJTUESIT TË MJETIT ADR

Në përputhje me Kapitullin 8.2, pika 8.2.2.8.5, të Marrëveshjes “Për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme ADR”

CERTIFIKATA E TRAJNIMIT E DREJTUESIT TË MJETIT ADR ADR DRIVER TRAINING CERTIFICATE	
AL	
Foto e drejtuesit të mjetit	1. CERTIFIKATA Nr: CERTIFICATE No:
	2. MBIEMËR SURNAME EMËR: NAME:
	3. DATA E LINDJES*: DATE OF BIRTH:
	4. KOMBËSIA: NATIONALITY:
	5. NËNSHKRIMI: DRIVER SIGNATURE:
	6. INSTITUCIONI: ISSUING BODY:
	7. VLEFSHMËRIA: VALID TO:*

(Pjesa përpara)

E VLEFSHME PËR KLASËN/ KLASAT OSE NUMRAT UN Nr.: VALID FOR CLASS (ES) OR UN Nos.:	
CISTERNA TANKS	TË TJERA OTHER THAN TANKS
9. Shëno klasën/ klasat ose numrin UN nr**: Enter Class or UN Number/ s:	10. Shëno klasën/ klasat ose numrin UN nr**: Enter Class or UN Number/ s:

(Pjesa mbrapa)

* Formati: data/ muaji/ viti

** Zëvendësohet teksti me të dhënat e përshtatshme

Shënim: Dimensionet e certifikatës të jenë në përputhje me ISO 7810: 2003 ID-1 dhe të jetë prej materiali plastik. Ngjyra duhet të jetë e bardhë me shkronja të zeza. Ajo duhet të përmbajë veçori shtesë të sigurisë të tillë si një hologram, printim ultraviolet ose modele guilloché.



UDHËZIM

Nr. 14, datë 2.11.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 3.2.2022,
“PËR PROGRAMIN, TRAJNIMIN,
TESTIMIN DHE LËSHIMIN E
CERTIFIKATËS PËR KËSHILLTARËT E
SIGURISË NË TRANSPORTIN E
MALLRAVE TË RREZIKSHME DHE
TARIFAT PËRKATËSE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, 30, 31, të ligjit nr. 118/2012, datë 13.12.2012, “Për transportin e mallrave të rrezikshme”, dhe neneve 115/1, 119, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; të nenit 68, të ligjit nr. 142, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 5, datë 3.2.2022, “Për programin, trajnimin, testimin dhe lëshimin e certifikatës për këshilltarët e sigurisë, në transportin e mallrave të rrezikshme dhe tarifave përkatëse”, bëhen këto ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

1. Në nenin 9, pas pikës 2.6, shtohen pikat 2.7, 2.8 dhe 2.9, me përmbajtjen si më poshtë:

“2.7 Mungesa e pjesëmarrjes në trajnim përbën shkak për moslejimin e kryerjes së testimit. Për këtë qëllim, evidentimi i pjesëmarrjes kryhet me nënshkrimin nga kandidati të fletëve të regjistrimit ose në mënyrë elektronike.

2.8 Kandidatët që do të pajisen me Certifikatën e Këshilltarit të Sigurisë duhet të jenë me profesion inxhinierë mekanikë, inxhinierë kimistë dhe/ose inxhinierë naftë dhe gazi.

2.9 Numri minimal i kandidatëve për fillimin e kurseve të trajnimit të jetë 10 persona. Në raste të veçanta, ky numër mund të ndryshojë, në varësi të kërkesave të të interesuarve dhe të infrastrukturës së trajnimit (ambientet e trajnimit, trupa e trajnimit, etj.).”.

Neni 2

1. Në nenin 12, pika 5, riformulohet, si më poshtë:

“5. Komisioni i testimit përgatit detyrat me shkrim për testimin, informon kandidatët për këshilltarë sigurie mbi procedurën e zhvillimit të testimit, zhvillon testimin dhe pas shqyrtimit të rezultateve të tij, ua komunikon kandidatëve, si dhe plotëson dokumentacionin përkatës”.

Neni 3

1. Në aneksin II, (organizimi i testimit), pas pikës 9, shtohet pika 10, me përmbajtjen si më poshtë:

“10. Për rinovimin e certifikatës së trajnimit, kandidatët do të marrin një pyetësor, i cili përfshin 20 pyetje të hapura, që mbulojnë minimalisht çështjet e cituara në këtë aneks (përkatësisht kapitujt 1.8.11 të ADR-së). Si dhe bazuar në programin përkatës të trajnimit të përcaktuar në këtë udhëzim”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSMINISTËR DHE MINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

URDHËR

Nr. 125, datë 12.10.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 111, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, të ndryshuar; dhe të VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, zëvendësministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë znj. Enkelejda Muçaj, për miratimin ose refuzimin e kërkesave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, të cilat nuk janë objekt koncesioni, nënshkrimin e kontratave dhe transferimin e miratimeve, sipas VKM-së nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, e ndryshuar.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga znj. Enkelejda Muçaj, zëvendësministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, znj. Enkelejda Muçaj, për zbatimin e këtij urdhri.

4. Urdhri nr. 167, datë 8.9.2022, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR

Nr. 241, datë 23.10. 2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDHRIN NR. 99, DATË 25.5.2021,
“PËR MIRATIMIN E KATALOGUT
KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE
PROFESIONALE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të nenit 17, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 99, datë 25.5.2021, “Për miratimin e Katalogut Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale”, i ndryshuar, në pikën 1, pas togfjalëshit “sipas shtojcës 1,” shtohet togfjalëshi “si dhe shtojcës 2”.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Ervin Mete

SHTOJCA 2

Nr.	Varianti i mëparshëm i Kualifikimit Profesional	Kodi i Kualifikimit Profesional	Emërtimi i kualifikimeve	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me Kodet e LKP/ISCO	Niveli në KSHK	Niveli në KEK
1	A2-III-18	A2-III-23	Teknologji e prodhimit të pijeve	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës në industrinë ushqimore	8160	3	3
2	A3-III-17	A3-III-22	Teknologji e përpunimit të qumështit	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës në përpunimin e qumështit	7515	3	3
3	A-IV-18	A-IV-23	Teknologji ushqimore	Program 1 vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Punonjës në teknologjinë ushqimore	751	4	4
4	B4-III-18	B4-III-22	Punime dhe riparim rrugësh	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punonjës për punime dhe riparime rrugësh	7113.22	3	3
5	B-IV-19	B-IV-23	Ndërtim	Program 1 vit studimi për teknik/menaxher mesëm	Teknik, mbikëqyrës, përgjegjës	3119.15	4	4
6	C2- III-17	C2- III-23	Prodhime druri gjysmë të gatshme	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor për prodhimin e produkteve gjysmë të gatshme	7521	3	3
7	D-II-17	D-II-22	Tekstil-Konfeksione	Program 2-vjeçarë studimi për punonjës ndihmës	Punonjës të tekstileve, të lëkurës, veshjeve dhe të ngjashme me to	753	2	2
8	D1-III-19	D1-III-23	Rrobaqepësi	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Rrobaqepës	7531	3	3
9	F1-III-19	F1-III-23	Makina metalpunuese	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë dhe montues të	7223	3	3



Nr.	Varianti i mëparshëm i Kualifikimit Profesional	Kodi i Kualifikimit Profesional	Emërtimi i kualifikimeve	Lloji i kualifikimit profesional	Profesionet LKP	Lidhja me Kodet e LKP/ISCO	Niveli në KSHK	Niveli në KEK
					makinerive metal punuese			
10	F2-III-18	F2-III-23	Konstruksione metalike	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm	7214	3	3
11	G2-III-16	G2-III-22	Kuzhinë - Pasticëri	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Kuzhinier, pasticëri	5120	3	3
12		H/1-IV-22	Agrobiznes	Programe 4 vjeçar studimi për teknik/menaxher i mesëm	Prodhuës në fermat bujqësore dhe blegtorale	6130	4	4
13		H1-V-23	Menaxhimi i cilësisë në prodhimin bujqësor	Programe pas të mesëm një vjeçar	Menaxher dhe mbikëqyrës i prodhimeve bujqësore	6111	5	5
14	I-IV-16	I-IV-23	Gjeologji - Miniera	Programe 1 vit studimi për teknik/menaxher i mesëm	Përgjegjës në minierë	3121	4	4
15	J-IV-17	J-IV-23	Detari	Programe 1 vit studimi për teknik/menaxher i mesëm	Punonjës peshkimi në thellësi (det të hapur)	6223	4	4
16	L2-IV-19	L2-IV-23	Sigurime	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Specialit sigurimesh	3321	4	4
17	L4-IV-19	L4-IV-23	Llogari	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Llogaritar	4311	4	4
18	L5-IV-19	L5-IV-23	Sipërmarrje e Agjencisë Turistike	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Nëpunës në agjencitë e udhëtimit	4224	4	4
19	L6-IV-20	L6-IV-23	Tregti	Programe 2-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Tregtar	5221.07	4	4
20	M4-III-18	M4-III-23	Shërbime karrocërie	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtor për shërbime karrocërie	7231.25	3	3
21	M-IV-15	M-IV-23	Shërbime mjeteve transporti	Programe 1 vit studimi për teknik/menaxher i mesëm	Teknik të shërbimeve të automjeteve	7231	4	4
22	M1-V-10	M1-V-23	Diagnostikim-menaxhim në autoservis	Programe pas të mesme 1 vjeçar	Teknik inxhinieri/mekanik (automjete)	3115.13	5	5
23	O-II-17	O-II-22	Shërbime Sociale dhe Shëndetësore	Programe 2-vjeçare studimi për punonjës ndihmës	Punonjës të kujdesit personal/ndihmës	53	2	2
24		O1-V-23	Parukeri e avancuar	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Punonjës të kujdesit personal/ndihmës	53	5	5
25		O2-V-23	Estetikë e avancuar	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Punonjës të kujdesit personal/ndihmës	53	5	5
26		O3-V-23	Masazheri estetikokuruese	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Punonjës të kujdesit personal/ndihmës	53	5	5
27		O4-V-23	Fizioterapi estetike	Programe, pas të mesme 2-vjeçare studimi	Punonjës të kujdesit personal/ndihmës	53	5	5
28		V-IV-23	Termohidraulikë	Programe 1-vjeçare studimi për teknik/menaxher i mesëm	Hidraulik në banesa dhe ujësjellës	7126	4	4
29	X1-III-16	X1-III-23	Nxjerrja e naftës, gazit dhe ujit	Program 1 vit për punonjës të kualifikuar	Punëtorë të shpimeve dhe të tjerë që lidhen me to	8113	3	3

**URDHËR****Nr. 640, datë 6.11.2023****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të VKM-së nr. 608, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari, nga data 7.11.2023 deri më datë 8.11.2023.

2. Në ushtrim të kompetencave të titullarit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministri ushtron këto përgjegjësi kryesore:

a) Trajton dhe nënshkruan përgjigjet zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore, personave fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, për të gjitha çështjet që janë brenda fushës së veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe që lidhen me ushtrimin e funksionit të drejtimit administrativ të institucionit, përveç kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor;

b) Ndjek dhe kontrollon veprimtarinë e nëpunësve të aparatit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe institucioneve të varësisë të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

c) Bën ndarjen dhe mbikëqyr realizimin e detyrave nga nëpunësit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në funksion të drejtimit dhe administrimit të përditshëm të veprimtarisë së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

3. Në ushtrimin e kompetencave sipas këtij urdhri, zëvendësministri ndihmohet dhe mbështetet nga sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ose personi që ushtron detyrat e tij në rast mungese. Zëvendësministri ndalohe

nëndelegojë te një organ i tretë kompetencat e përfituara përmes këtij akti delegimi.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Arian Jaupllari.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

VENDIM**Nr. 281, datë 25.9.2023**

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“DRAGOBIA ENERGY” SHPK PËR
MARRJEN E AUTORIZIMIT TË ERE-s,
PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ
SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR
GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË
TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 5, 8 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut / aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/ aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit /eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2048/5 prot., datë 21.9.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dragobia Energy’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguroese) për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë



elektrike nga HEC “Cerem” dhe “Dragobi”, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 6.2.2016, dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 98, datë 16.4.2021.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048 prot., datë 21.8.2023, i licencuari “Dragobia Energy” sh.p.k. dhe ortaku i vetëm i saj/koncesionari “Gener 2” sh.p.k., kanë paraqitur kërkesën për dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë koncesionare “Dragobia Energy” sh.p.k. si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj palëve të treta, konkretisht ndaj shoqërive “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a., “Banka e Tiranës” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a.

- ERE, me shkresën nr. 2048/2 prot., datë 7.9.2023, i është drejtuar shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. duke evidentuar dokumentacionin e konstatuar të munguar, të këtij aplikimit. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2048/3 prot., datë 11.9.2023, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Rezulton se shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. plotëson kërkesat si vijon:

- Neni 8, pika 1, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”;

- Neni 8, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e”.

Shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Dragobia Energy” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese), për garantimin e detyrimit ndaj shoqërive “Bankës Amerikane të Investimeve” sh.a., “Bankës së Tiranës” sh.a. dhe “Union Bank” sh.a.

2. Dhënia e autorizimit nga ana e ERE-s, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e zhvesh shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë miratimin nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe organeve të tjera përkatëse nëse kërkohet sipas akteve ligjore në fuqi në çdo moment që ndodh transferimi.

3. Shoqëria të njoftojë ERE-n pas shlyerjes së plotë të kredisë dhe heqjes së barrës siguruese mbi kuotat e saj.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k., shoqërinë “Gener 2” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 282, datë 25.9.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK “TEKSOEN 1”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe



të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/9 prot., datë 21.9.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘IDI 2005’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik ‘Teksoen 1’ me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.8.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw dhe me vendimin nr. 255, datë 23.8.2023, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.8.2023 dhe 25.8.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 2.9.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresat nr. 2033/3 prot., datë 7.9.2023, nr. 2033/4 prot., datë 12.9.2023 dhe nr. 2033/7, datë 19.9.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar respektivisht dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.

- Në vijim, shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2033/5, datë 12.9.2023, nr. 2033/6 prot., datë 15.9.2023 dhe me *email*-in protokolluar me nr. 2033/8 prot., datë 20.9.2023, ktheu përgjigje duke plotësuar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar.

- Vlefshmëria e licencave që ERE ka lëshuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaiike është bazuar në jetëgjatësinë e paneleve, për të cilën subjektet e kanë plotësuar aplikimin mbi dokumentacionin teknik/garancitë teknike (depozituar dokumentacioni vërtetues për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. që referon këtë

jetëgjatësi, e në vijim është përcaktuar afati i vlefshmërisë së licencës).

- Në nenin 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Me qëllim komunikimin me shoqërinë për të sqaruar dokumentacionin teknik dhe arritjen në një përfundim se sa vite do të jetë licenca për këtë subjekt, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbi të cilën e bazon jetëgjatësinë e centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. të depozitojë dokumentacionin teknik mbi të cilën e bazon jetëgjatësinë e centralit fotovoltaiik.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 283, datë 25.9.2023

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 21, DATË
25.1.2021, “MBI LICENCIMIN E
SHOQËRISË ‘GREENTECH ENERGY
SYSTEMS’ SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA HEC ‘PISHAT’, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 1911 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1227/6 prot., datë 22.9.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 25.1.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Greentech Energy Systems’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Pishat’ me kapacitet të instaluar 1911 kw”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 21, datë 25.1.2021, vendosi të licencojë shoqërinë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Pishat”, me kapacitet të instaluar 1911 kw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që në përfundim të afatit të lejes së përdorimit uJOR (data e përfundimit 11.5.2022), shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k. duhet ta dorëzojë këtë leje me afate të rinovuara jo më vonë se një muaj pas rinovimit.

- ERE iu drejtua shoqërisë me shkresat nr. 476 prot., datë 7.4.2022, nr. 843 prot., datë 26.5.2022, duke i kujtuar detyrimin për të depozituar në ERE informacion mbi aplikimin për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor dhe depozitimin e saj brenda datës 11.5.2022.

- Në përgjigje me shkresën e depozituar në ERE me nr. 843/1 prot., datë 20.6.2022, shoqëria ka depozituar informacion mbi aplikimet bëra në datën 29.10.2021, me numër AN291020210002 dhe në

datën 10.5.2022 ka riaplikuar me numër aplikimi AN100520220019.

-Ndërkohë, ERE, me shkresën e protokolluar me nr. 1127 prot., datë 11.4.2023, është vënë në dijeni nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., si dhe nga Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sh.a. me shkresën nr. 1230 prot., datë 11.4.2023, mbi dy masat administrative të marra (gjorbë dhe pezullim aktiviteti) nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), për shoqërinë “Greentech Energy Systems” sh.p.k. deri në rinovimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor.

-ERE, me shkresën nr.1227/1 prot., datë 5.5.2023, ka bërë me dije operatorët e rrjetit se: “Për sa vënë në dije mbi masat administrative të marra nga ana e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT) mbi vendimin e marrë për pezullimin e aktivitetit deri në rinovimin e lejes së përdorimit të burimit uJOR, në parashikim të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, organet kompetente për marrjen e masave në lidhje me subjektet që ushtrojnë aktivitetin në fushën e prodhimit të energjisë elektrike janë inspektoratet përgjegjëse. Si e tillë të mbahet në konsideratë sa përcaktohet në vendimin e organeve kompetente tashmë të disponuar nga operatorët e sistemit.

-Për sa më sipër, në komunikim me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), ERE ka vlerësuar ridërgimin e shkresës me nr.1397 prot., datë 11.5.2023, për të sqaruar statuset juridike për një sërë subjektesh në trajtim të problematikës me lejet e përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor, ndër to renditet dhe shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., kjo për qëllim të rishikimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 21/2021.

-AMBU-ja, në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr.1397/1 prot., datë 19.5.2023, ka konfirmuar se aplikimi është në fazën e trajtimit nga organet e menaxhimit të burimeve ujore.

-Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 615/1 prot., datë 25.7.2023 dhe nr. 1227/4 prot., datë 20.8.2023, ka depozituar lejen e përdorimit të burimit uJOR sipërfaqësor me nr. serie 000123, nr. 632 prot., datë 5.7.2023, të miratuar me vendimin nr. 18, datë 29.6.2023, të Këshillit të Basenit UJOR (KBU) Seman për përdorimin e burimit uJOR



sipërfaqësor nga HEC “Pishat”, me një afat 5-vjeçar, me afat vlefshmërie deri më 29.6.2028.

-Me depozitim e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 21/2021, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Pishat” brenda datës 29.6.2028.

- Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 21/2021, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “Greentech Energy Systems” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Pishat” brenda datës 29.6.2028.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 284, datë 25.9.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 99, DATË 16.4.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘GERTI’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘VARDARI’ ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 kw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 99, datë 16.4.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.9.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 307/4 prot., datë 21.9.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Vardari’ me kapacitet të instaluar 1972 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 208, datë 17.8.2022, ndër të tjera, në pikat 2, 4 dhe 5 ka vendosur detyrimin e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. që brenda 6 (gjashtë) muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, shoqëria “Gerti” sh.p.k. të depozitojë në ERE: çdo dokument që vërteton kalimin e pronësisë apo dhënien në përdorim të aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.

- Të dokumentojë në ERE transferimin e kontratës së qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjqor dhe kullësor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC “Vardari”, të lidhur me Bashkinë Librazhd, nga Drini Bulqizë sh.p.k. tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.

- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujqor (data e përfundimit 16.10.2022), shoqëria “Gerti” shpk, ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.



- Në lidhje me kushtin i cili ka të bëjë me depozitimin e çdo dokumenti që vërteton kalimin e pronësisë apo dhënien në përdorim të aseteve nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “Gerti” sh.p.k. shoqëria, në kuadër të aplikimit për licencim, ka depozituar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratën e shitblerjes së kuotave të HEC “Vardarit” me nr. 744 rep., nr. 147/2 kol, datë 14.6.2020, lidhur ndërmjet shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë “Gerti” sh.p.k. në cilësinë e blerësit, në të cilën pasqyrohet shitja e 100% të kuotave të HEC “Vardari”.

- Amendimin e kontratës së koncesionit nr. 1818 rep dhe nr. 388/2 kol., datë 24.12.2020, “Për kontratën e ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të hidrocentralit ‘Vardari’ me kapacitet 1.972 mw, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan”, të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. i janë transferuar shoqërisë “Gerti” sh.p.k.

- Marrëveshjen e lidhjes së re me nr. 3045/2 prot., datë 3.3.2021, të nënshkruar midis shoqërisë “Gerti” sh.p.k. dhe OSSH sh.a., për lidhjen e HEC “Vardari” me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Lejen e përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor të transferuar nga “Drini Bulqizë” tek shoqëria “Gerti” sh.p.k.

- VNM-ja paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), me nr. 858 prot., datë 5.4.2017, me nr. 211 identifikimi dhe nr. 14 vendimi, për personin juridik “Drini Bulqizë” sh.p.k., “Për të zhvilluar projektin e HEC ‘Vardari’”. Duke qenë se shoqëria ka bërë me dije se punimet e HEC ndodheshin në fazën finale, atëherë leja mjedisore është konsideruar e vlefshme.

- Nga dokumentacioni i sipërcituar, shoqërisë i është lënë kusht në vendimin e licencimit për të depozituar kontratën “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC ‘Vardari’”, e lidhur ndërmjet palëve, Bashkisë Librazhd dhe subjektit “Gerti” sh.p.k., pasi kjo kontratë ishte ende në emër të subjektit “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe ishte i vetmi dokumentacion i pa ndryshuar në aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 307/1 prot., datë 23.3.2023, shoqëria depozitoi

amendim kontrate me nr. 4609 prot., datë 14.10.2022, për kontratën nr. 5006/1 prot., datë 8.8.2017, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC ‘Vardari’”, e lidhur mes palëve Bashkisë Librazhd dhe subjektit “Gerti” sh.p.k. Me depozitimin e këtij dokumentacioni vlerësojmë se shoqëria ka plotësuar sa kërkuar në vendimin nr. 99/2021, të ndryshuar.

- Në kuptim të kërkesave të pikave 2 dhe 4, të vendimit të licencimit nr. 99/2021, të ndryshuar, të cilat lidhen me pronësinë dhe të drejtën e shfrytëzimit të HEC “Vardari”, rezulton se tashmë i gjithë dokumentacioni është në emër të subjektit “Gerti” sh.p.k., vlerësojmë që kushti i vendosur në pikën 2 të këtij vendimi të konsiderohet i plotësuar dhe të shfuqizohet. Ndërsa në lidhje me kushtin e vendosur në pikën 4 të vendimit, në vijim të shkresës së depozituar nga shoqëria dhe protokolluar në ERE me nr.307/1 prot., datë 23.3.2023, në të cilën ka depozituar amendim kontrate me nr. 4609 prot., datë 14.10.2022, për kontratën nr.5006/1 prot., datë 8.8.2017, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik, ndërtim dhe shfrytëzim HEC ‘Vardari’”, e lidhur mes palëve Bashkisë Librazhd dhe subjektit “Gerti” sh.p.k. për një afat 10-(dhjetë)-vjeçar duke filluar nga data 07.8.2017 deri më datë 7.08.2027, me të drejtë rinovimi, konstatojmë se kjo kontratë nuk mbulon të gjithë afatin e vlefshmërisë së licencës së shoqërisë dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësojmë që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE kontratën e qirasë me Bashkinë Librazhd me afat të rinovuar brenda datës 7.8.2027, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.

- Për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi, rezulton se shoqëria “Gerti” sh.p.k. ka depozituar lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor me nr. serie 000104, nr. 193 prot., datë 28.2.2023, të miratuar me vendimin nr. 7, datë 23.2.2023, të Këshillit të Basenit Ujqor (KBU) Shkumbin për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për HEC “Vardari”, me një afat 5-vjeçar, deri më datë 23.2.2028.

- Me depozitimin e këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 99/2021, të ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të



depozitohet në ERE lejen e rinovuar, për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Vardari”, brenda datës 23.2.2028.

Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“3. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor, për prodhim hidroenergjie nga HEC “Vardari”, brenda datës 23.2.2028.”.

3. Pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 99, datë 16.4.2021, të ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

“4. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. duhet të depozitohet në ERE kontratën e qirasë së rinovuar me Bashkinë Librazhd, jo më vonë se data 7.8.2027, ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë në zonën ku shtrihet projekti.”.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë